



Crna Gora / Mali i Zi  
Opština Ulcinj  
Komuna e Ulqinit  
Kabinet Predsjednika  
Kabineti i Kryetarit

Crna Gora - Mali i Zi  
Opština Ulcinj - Komuna e Ulqinit  
Kryetari / Kryetare  
12.12.2024  
02-040/24-587/1

Adresa: Bul. Skenderbega/Skenderbeu  
85360 Ulcinj/Ulqin, Crna Gora/Mali i Zi  
tel: +382 30 412 050  
e-mail: kabinet@ul-gov.me

Br./Nr. 01-040/24-1834/3

Ulcinj/Ulqin, 13.12.2024

**KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT- SKUPŠTINA OPŠTINE ULCINJ**  
**Kryetares së Kuvendit/ Predsjednici Skupštine**

KËTU/OVDJE

E nderuara/ Poštovna,

Në bazë nenit 58 paragrafi 1 alinea 2 Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Fleta zyrtare e MZ", br. 2/2018, 34/2019, 38/2020, 50/2022, 84/2022 – Vendimi i GjK MZ i 85/2022 – përmirësimi i Vendimit GjK MZ) dhe nenit 65 të Statutit të Komunës ("Fleta zyrtare e MZ – Regloret komunale", br. 48/2019 i 5/2024), në shtojcë ju dërgojmë propozim Vendimin për dhënien e pëlqit për Programin e punës dhe planin financiar të IP-së "Qendra për Kulturë" Ulqin për vitin 2025, që ta shqyrtoni dhe të vendosni. Përpunues i këtij Vendimi është Sekretariati për kulturë dhe veprimtari shoqërore. Raportues i këtij Vendimi do të jetë sekretarja e Sekretariatit për kulturë dhe veprimtari shoqërore.

Na osnovu člana 58 stav 1 aline 2 Zakona o lokalnoj samoupravi ("Službeni list CG", br. 2/2018, 34/2019, 38/2020, 50/2022, 84/2022 - Odluka US CG i 85/2022 - ispravka Odluke US CG) 65 Statuta Opštine ("Službeni list CG – Opštinski propisi", br. 48/2019 i 5/2024), u prilogu Vam dostavljamo, predlog Odluke o davanju saglasnosti na Program rada i finansijski plan JP "Centar za Kulturu" Ulcinj za 2025.godinu.,na razmatranje i odlučivanje. Obradivač ove Odluke je Sekretarijat za kulturu i društvenu djelatnost. Izvjestila ove Odluke biće sekretarka Sekretarijata za kulturu i društvenu djelatnost.

Me rrespekt/ S poštovanjem,

Kryetari/Predsjednik  
Genci Nimanbegu



*Genci Nimanbegu*

Në bazë të nenit 38 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 2/18, 34/19, 38/20, 50/22, 84/22 dhe 85/22), nenit 58, paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat e Komunës", nr. 48/19), nenit 139 të Regullores së punës të Kuvendit të Komunës së Ulqinit ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat e Komunës", nr. 27/20 dhe 5/24) dhe në lidhje me nenet 25 dhe 49 të Statutit të Institucionit Publik „Qendra për Kulturë – Ulqin”, Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_ .12.2024 ka sjellë

## V E N D I M I N

për dhënien e pëlqimit mbi Programin e punës dhe planin financiar të IP-së „Qendra për kulturë – Ulqin“ për vitin 2025

### Neni 1

Jepet pëlqimi mbi Programin e punës dhe planin financiar të IP-së “Qendra për Kulturë – Ulqin” për vitin 2025, i cili është miratuar nga Këshilli me vendimin e evidentuar nr. 842/24, më datë 09.12.2024.

### Neni 2

Vendimi hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Fletoren Zyrtare të Malit të Zi – Dispozitat e Komunës”.

Numër: 02- 016/24-\_\_\_\_\_  
Ulqin, më \_\_\_\_ .12.2024

**K R Y E T A R J A**  
Ivana Popović

**KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT**

## Arsyetimi

Baza ligjore për marrjen e këtij vendimi është e përcaktuar në nenin 38 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, si dhe në nenin 58 paragrafi 1 pika 2 të Statutit të Komunës së Ulqinit, të cilët përcaktojnë se Kuvendi miraton rregullore dhe akte të tjera të përgjithshme. Neni 139 i Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Ulqinit përcakton se, në procesin e përgatitjes dhe miratimit të planeve, programeve të punës dhe zhvillimit të shërbimeve publike dhe subjekteve të tjera juridike, të cilat themelohen nga shteti dhe funksionojnë në territorin e Komunës, Kuvendi shqyrton draftet e këtyre akteve, jep propozime për përmirësimin e tyre dhe ndjek realizimin e tyre.

Sipas dispozitave pozitive të IP-së "Qendra për Kulturë – Ulqin", përfshirë Statutin e Qendrës në nenin 49, përcaktohet ndër të tjera se këshilli miraton ndryshimet dhe plotësimet e Statutit, ku procedura nis nga drejtori i Qendrës, në përputhje me planet zhvillimore të Qendrës ose për përmirësimin e kushteve dhe strukturës kadrovike, në mënyrën dhe sipas procedurës së përcaktuar për miratimin e tyre. Gjithashtu, përcaktohet se themeluesi i këtij institucioni publik jep pëlqimin për programin vjetor të punës dhe planin financiar.

Arsyet për miratimin e këtij Vendimi qëndrojnë në harmonizimin me dispozitat ligjore. Duke pasur parasysh që Këshilli i Qendrës, në mbledhjen e mbajtur më datë 09.12.2024 ka miratuar Programin e punës dhe Planin financiar për vitin 2025 nr. 842/24 dhe se për këtë program Sekretariati për Kulturë dhe Veprimtari Shoqërore ka dhënë mendim pozitiv, i propozohet Kuvendit të Komunës së Ulqinit miratimi i këtij akti.

## **Hartuesi**

Sekretariati për Kulturë dhe Veprimtari Shoqërore



CRNA GORA - MALI I ZI  
JU "CENTAR ZA KULTURU – ULCINJ"  
IP "QENDRA PËR KULTURË – ULQIN"

Br. 845/24  
Ulcinj, 09.12.2024. godine.



Crna Gora - Mali i Zi  
Opština Ulcinj - Komuna e Ulqinit

Primjeno - Prerubet:	09.12.2024
Organi - Niveli:	88
Numeri:	16-082/24-177/11
Prirubet - Prirubet:	
Vista:	

OPŠTINA ULCINJ

Sekretarijat za kulturu i društvene djelatnosti  
Sekretarka, Merita Subašić-Šabanović

Poštovani,

U prilogu Vam dostavljamo Plan rada i finansijski plan za 2025. godinu kao i Odluku o izmjenama i dopunama Statuta JU „Centar za kulturu – Ulcinj“.

S poštovanjem,

Direktorica  
  
Adriana Hoxha



CRNA GORA - MALI I ZI  
JU "CENTAR ZA KULTURU - ULCINJ"  
IP "QENDRA PËR KULTURË - ULQIN"

Br. 840/24  
Ulcinj, 09.12.2024.god.

Na osnovu člana 25 i 49 Statuta JU "Centar za kulturu - Ulcinj", kao i na osnovu člana 9 Poslovnika o radu Savjeta JU "Centar za kulturu - Ulcinj", na sjednici održanoj dana 09.12.2024.god. Savjet Centra donio je

**ODLUKU**

**o donošenju Programa rada i Finansijskog plana JU "Centar za kulturu - Ulcinj" za 2025. godinu**

**Član 1.**

Ovom odlukom donosi se Programa rada i Finansijski plan JU "Centar za kulturu - Ulcinj" za 2025.godinu, br.840/24 od dana 09.12.2024.god.

**Član 2.**

Program rada i Finansijski plan za 2025. godinu dostavlja se na saglasnost Skupštini opštine Ulcinj kao osnivaču.

**Član 3.**

Ova odluka stupa na snagu danom donošenja.

**Obrazloženje**

Članom 25 Statuta JU "Centar za kulturu - Ulcinj", propisano je da se poslovanje Centra planira godišnjim finansijskim planom i programom rada, koji se donose prije početka godine na koju se odnose, predlog finansijskog plana i programa rada utvrđuje direktor Centra u saradnji sa rukovodiocima organizacionih jedinica a Program rada i Finansijski plan donosi Savjet Centra.

Članom 49 Statuta JU "Centar za kulturu - Ulcinj", kao i članom 9 Poslovnika o radu savjeta propisano je da Savjet između ostalog donosi Program rada.

Na sjednici održanoj dana 09.12.2024.god. Savjet je donio odluku o donošenju Programa rada i Finansijskog plana JU "Centar za kulturu - Ulcinj" za 2025. godinu.

**Predsjednica,**



**Azra Mešić-Radončić**

*Azra Mešić-Radončić*

JU "CENTAR ZA KULTURU - ULCINJ"  
IP "QENDRA PËR KULTURË - ULQIN"  
D.Nr. 842/24  
Ulcinj-Ulcinj, 09.12.2024



CRNA GORA - MALI I ZI  
JAVNA USTANOVA "CENTAR ZA KULTURU - ULCINJ"  
INSTITUCIONI PUBLIK "QENDRA PËR KULTURË - ULQIN"

**PLAN RADA I FINANSIJSKI PLAN ZA 2025. GODINU  
PLANI I PUNËS DHE PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2025**

**ULCINJ, 09.12.2024. GODINE**

**ULQIN, MË 09.12.2024**

---

JU "CENTAR ZA KULTURU - ULCINJ" / IP "QENDRA PËR KULTURË - ULQIN"  
Crna Gora - Mali i Zi - Montenegro, 85360 Ulcinj - Ulqin, Bul. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"  
p.nr., E-mail: [kultura.ul@gmail.com](mailto:kultura.ul@gmail.com)

## **Informacion i përgjithshëm**

IP "Qendra për Kulturë – Ulqin" është institucion i themeluar nga Kuvendi, gjegjësisht Komuna e Ulqinit dhe veprimtaria e tij është avancimi dhe zhvillimi i kulturës në komunën e Ulqinit. Qendra për Kulturë është themeluar me vendimin nr. 01-153/92-7 të datës 11.02.1992 dhe së fundmi, në fund të vitit 2022, Kuvendi i Komunës së Ulqinit miratoi Vendimin nr. 02-016/22-553-9, ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 6/2023) për riorganizimin e Ndërmarrjes Publike "Qendra për Kulturë" Ulqin në Institucionin Publik "Qendra për Kulturë – Ulqin". Sipas Statutit të ri nr. 373 të datës 22.12.2022, në IP-në "Qendra për Kulturë – Ulqin" ekzistojnë këto njësi organizative:

- Shërbimi i përbashkët;
- Shtëpia e Kulturës;
- Biblioteka Popullore;
- Muzeu i Qytetit.

Veprimtaritë kryesore të Qendrës për Kulturë janë prodhimi, organizimi dhe realizimi i programeve nga të gjitha fushat e krijimtarisë kulturore dhe artistike, veprimtaritë botuese, organizimi i manifestimeve dhe festivaleve kulturo-artistike, veprimtaria bibliotekare, veprimtaria muzeale. Momentalisht në Qendër për Kulturë ka 23 të punësuar, të ndarë në njësi punuese, ku mund të themi se në secilën njësi ka mungesë kuadrosh profesional, teknik dhe ndihmës.

## **SHTËPIA E KULTURËS**

- Do të kultivojë traditën e qytetit të Ulqinit, folklorin, veshjet, vallet. Planifikohet që Folklori të ketë valltarë, orkestër dhe të ketë pikat e veta interpretuese, me të cilat do të mund të përfaqësojë komunën tonë në çdo lloj aktiviteti, brenda dhe jashtë vendit.
- Në vitin 2025 planifikojmë t'i kushtojmë kujdes të veçantë etnofolklorit dhe këngës së vjetër qytetare.
- Do të formohet grupi i pjesëmarrësve të vegjël dhe të rritur, të cilët do të shfaqin pjesë të ndryshme skenike. Shfaqjet do të jenë produkte të Qendrës, me tematikë të ndryshme.
- Organizimi i koncerteve të ndryshme.
- Bashkëpunimi me subjekte të ndryshme, persona fizikë, Organizatën Turistike, Komunën e Ulqinit, Ministrinë e Kulturës etj.
- Do të organizohen aktivitete të ndryshme si promovime, mbrëmje debati, kuvendime e bashkëbisedime për tema të ndryshme, me qëllim të ngritjes së kulturës së debatit, lirisë së mendimit dhe ngritjes së kritikës. Temat do të jenë të ndryshme.
- Në Galerinë e Arteve të Qendrës për Kulturë do të organizohen ekspozita të ndryshme të arteve të ndryshme pamore.
- Planifikohen murale brenda hapësirave të Qendrës për Kulturë, zyreve, korridoreve, si dhe mural në hapësirë të hapur në pjesë atraktive të qytetit.
- Planifikohet organizimi i Kolonisë së piktorëve vendas e të huaj, të cilët përmes krijimtarisë së vet, do të realizojnë një prezantim nga perspektiva të ndryshme, të asaj se çka ofron qyteti i Ulqinit.

- të vazhdojë me regjistrimin e anëtarëve të rinj, ndërsa me propagandë përmes mjeteve të informimit publik të punojë në rritjen e numrit të përdoruesve të shërbimeve të Bibliotekës;
- të sistemohen nëpër grupet përkatëse librat në depo, të cilat janë grumbulluar gjatë vitit paraprak;
- të punohet në vazhdimësi në ruajtjen e materialit bibliotekar (posaçërisht ngjitjen e librave të vjetër, në mungesë të të rinjve);
- të vazhdojë me mbledhjen e materialit bibliotekar për Fondin e Vendlindjes;
- të sigurohet pajisja dhe të fillohet puna në sistemin bibliotekaro-informativ COBISS;
- të vazhdojë t'i japë ndihmë profesionale bibliotekave shkollore në kuadër të veprimtarisë amë;
- për nevojat e punës studimore të studiuesve të ndryshëm, studentëve dhe qytetarëve të tjerë edhe më tej do të vazhdojë me bashkëpunimin e mirë me Bibliotekën Nacionale të Malit të Zi dhe me bibliotekat tjera në vend dhe jashtë me qëllim të huazimit ndërbibliotekar;
- të vazhdohet e të avancohet bashkëpunimi me organizatat e sektorit civil;
- të vazhdohet e të avancohet bashkëpunimi me institucionet arsimore;
- të vazhdojë të bashkëpunojë me shtëpitë e njohura botuese me qëllim të prezantimit gjegj. organizimit dhe hapjeve të ekspozitave të librit;
- të vazhdojë e ta avancojë bashkëpunimin ndërbibliotekar;
- të vazhdojë e të avancojë bashkëpunimin me mediat lokale, me qëllim të propagandimit sa më të mirë të Bibliotekës, shërbimeve dhe aktiviteteve të saja;
- të zhvillojë bashkëpunimin me Organizatën Turistike të Ulqinit me qëllim të përfshirjes së Bibliotekës në ofertën turistike të qytetit dhe propagandimit të shërbimeve të saj për turistë.
- promovimi i krijuesve vendas, posaçërisht atyre të rinj;
- takime me shkrimtarë për fëmijë, si dhe gara për nxënësit e shkollave fillore dhe mesme nga Ulqini nga fusha e letërsisë;
- mbrëmje letrare, përrime të librave e revistave, ekspozita të fondeve bibliotekare, ekspozita figurative, takime letrare me shkrimtarë të njohur etj.;
- workshope për fëmijë dhe të rinj në Youth Corner;
- net të filmit në Youth Corner;
- mbrëmje të lojërave shoqërore në Youth Corner;
- vizita edukative të nxënësve nga institucionet parashkollore dhe atyre të klasave të ulëta të shkollave fillore, me qëllim të promovimit të Bibliotekës, librit dhe kulturës së të lexuarit;
- promovime të punimeve të magistraturës dhe doktoratës të studiuesve nga komuniteti lokal;
- tribuna dhe tryeza të rrumbullakëta, me tema të ndryshme që janë me interes për komunitetin lokal;
- shënimi i Ditës Botërore të Librit dhe të Drejtave të Autorit dhe i datave të tjera me rëndësi për librin dhe letërsinë;
- shënimi i Ditës Ndërkombëtare të të Rinjve;
- bashkëorganizimi i "Panairit të Librit";
- formimi i klubit të leximit për grupmosha të ndryshme;
- botimi i librave me ngjyra për fëmijë me tema të ndryshme nga fusha e trashëgimisë kulturore, historisë së Ulqinit, peizazheve dhe ngjashëm;
- dhe aktivitete e veprimtari të tjera bibliotekare dhe kulturore, të cilat do të paraqiten gjatë vitit në vijim.



- vendosja e rrjetit të ri elektrik;
- rregullimi i enterierit të Bibliotekës dhe të hapësirave të tjera, të goditura nga uji;
- instalimi i tubacioneve të reja të ujit – kanalizimit në deponë e Bibliotekës
- blerja e karrigeve të reja për sallën e leximit;
- Sigurimi i pajisjeve për vënien e sistemit COBISS: 2 (dy) kompjuterë, 1 (një) printer termal, 1 (një) lexues i bar-kodit dhe lidhja e internetit.

Për vitin 2025 parashihet të krijohet web-faqja e Qendrës për Kulturë, ku do të jenë të përfshirë të tri njësitë punuese.

Savjet JU „Centra za kulturu – Ulcinj“  
Këshilli i IP-së “Qendra për Kulturë – Ulqin”



Predsjednica/Kryetarja

Azra Mešić-Radončić

*Azra Mešić-Radončić*

**PLANI FINANCIAR I IP-së "QENDRA PËR KULTURË - ULQIN" PËR VITIN 2025**

Nr.		<b>A: TË HYRAT</b>		
		<b>1. TË HYRAT VETANAKE</b>		<b>54,000.00</b>
1	6122	Biblioteka	500.00	
2	61221	Muzeu	20,000.00	
3	61222	Hapësirat me qira	25,000.00	
4	61223	Të hyrat nga shfrytëzimi i sallës	5,000.00	
5	61225	Të hyrat nga biletat	3,500.00	
		<b>2. TË HYRAT NGA KOMUNA</b>		<b>550,000.00</b>
1	6402	Të hyrat e rregullta	400,000.00	
2	64021	Të hyrat e dedikuara	150,000.00	
	64022	<b>3. TË HYRAT E TJERA NGA MINISTRIA</b>		<b>10,000.00</b>
	64010	<b>4. TË HYRAT NGA ORGANIZATA TURISTIKE</b>		<b>20,000.00</b>
	6403	<b>5. TË HYRAT NGA DONACIONET DHE SPONSORIZIMET</b>		<b>5,000.00</b>
		<b>TË HYRAT - GJITHSEJ</b>		<b>639,000.00</b>
		<b>B: SHPENZIMET</b>		
		<b>I Shpenzime materiale</b>		<b>76,100.00</b>
1	5121	Materiali kancelarik	1,000.00	
2	5120	Shërbime pastrimi dhe dezinfektimi, materiale pastrimi	1,500.00	
3	5130	Shpenzimet e energjisë elektrike	20,000.00	
4	5312	Shpenzimet e shërbimeve të PTT	100.00	
5	5312	Interneti dhe telefoni për Muze, Bibliotekë dhe shërbimin e përbashkët - administratën	1,000.00	
6	5502	Shërbimet komunale	3,000.00	
7	5506	Ujesjellesi dhe kanalizimi	10,000.00	
8	5320	Shpenzimet e mirëmbajtjes, investime	30,000.00	
9	232	Blerja e kompjuterëve, printerëve etj.	5,000.00	
10	5350	Shpenzimet e reklamës dhe propagandës	2,000.00	
11	5359	Publikimet, revistat, literatura profesionale	1,500.00	
12	5129	Shpenzime të tjera	1,000.00	
		<b>II Shpenzime jomateriale</b>		<b>28,900.00</b>
1	52900	Meditje	600.00	
2	52902	Shpenzimet e udhëtimit për udhëtime zyrtare	1,000.00	
3	5510	Reprezentacion	3,000.00	
4	5530	Shpenzimet e transaksioneve bankare	1,000.00	
5	55031	Shpenzimet e auditimit të brendshëm të kontabilitetit	300.00	
6	5503	Shërbimet e kontabilitetit	3,500.00	
7	5505	Shpenzimet e avokatit	4,000.00	

8	5504	Shpenzimet e shërbimeve te konsulences, projekte dhe studime	7,000.00	
9	5133	Shpenzimet e naftës	500.00	
10	5310	Shpenzimet e transportit	1,000.00	
11	5336	Shpenzimet e akomodimit të pjesëmarrësve të aktiviteteve	7,000.00	
	52	<b>III Shpenzimet e pagave të punëtorëve</b>		<b>447,000.00</b>
1	520/521	<b>Pagat bruto të punëtorëve</b>	380,000.00	
2	520/521	Reprogrami i borxhit ndaj Administratës Tatimore	27,000.00	
3	5260	Kompensimet bruto për anëtarët e Këshillit Drejtues	25,000.00	
4	5220	Kompensime të tjera (kontrata mbi vepër)	15,000.00	
		<b>IV Mjetet e dedikuara</b>		<b>87,000.00</b>
		<b>Sipas plan-programit</b>		
1	O265	Furnizimi me libra të rinj	5,000.00	
2	O264	Blerja e artefakteve te reja	2,000.00	
3	5593	Aktivitete kulturore të Bibliotekës	5,000.00	
4	5594	Aktivitete kulturore të Shtëpisë së Kulturës	45,000.00	
5	5595	Aktivitete të Muzeut	5,000.00	
6	5596	Folklori	5,000.00	
7	5597	Kënga qytetare - Etnofolklori	5,000.00	
8	5320	Vendosja e kamerave te sigurise	2,000.00	
9	5320	Trashëgimia kulturore - krojet e vjetra	5,000.00	
10	5599	Bashkëorganizime	5,000.00	
11	5320	Mirëmbajtja e materialit muzeal	2,000.00	
12	53591	Përgatitja e web-faqes	1,000.00	
		<b>SHPENZIME - GJITHSEJ</b>		<b>639,000.00</b>

Këshilli i IP-së "Qendra për Kulturë - Ulqin"  
Kryetarja

Azra Mešić-Radončić

*Azra Mešić-Radončić*